

THIRRJE PËR AVOKAT

Për ofrimin e ndihmës juridike falas për grupet e marginalizuara në zonën e Shkodrës

Tiranë, më 13.06.2022

Qendra për Nisma Ligjore Qytetare në kuadrin e projektit “Zgjerimi i Shërbimeve Ligjore Falas për Gratë dhe Burrat në Shqipëri”, zbatuar nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim UNDP në partneritet me Ministrinë e Drejtësisë me fonde të Agjencisë Austriake për Zhvillim kërkon të kontrakttojë një avokat për të ofruar ndihmë juridike parësore dhe dytësore pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër në bashkëpunim me Qendrën e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore pranë kësaj gjykate..

➤ **Përshkrimi i detyrave:**

Avokati/ja do të angazhohet për kryerjen e detyrave si më poshtë:

- Avokati/Avokatja duhet të ofrojë ndihmë juridike parësore dhe dytësore për grupet e marginalizuara, si fokus i veçantë i këtij projekti. Ndhima juridike dytësore do të ofrohet duke përfshirë por pa u kufizuar, mbështetjen e personave me aftësi të kufizuara, e përfaqësuesve të komunitetit rom dhe egjiptian, grave rurale, grave viktime të formave të ndryshme të dhunës me bazë gjinore, të moshuarve, të miturve, personave që nuk kanë mundësi ekonomike të paguajnë një avokat etj.
- Avokati/Avokatja ka për detyrë të bashkëpunojë me Bashkinë Shkodër, Njësitë Administrative të Bashkisë Shkodër, anëtarët e Mekanizmit të Koordinuar të Referimit të rasteve të dhunës në familje për arritjen e qytetarëve në nevojë që të përfitojnë ndihmë juridike parësore dhe dytësore falas.
- Avokati/Avokatja duhet të ofrojë ndihmë juridike dytësore falas për të paktën 31 raste deri në përfundim të Projektit.
- Avokati/Avokatja duhet të kontribuojë në lehtësimin e organizimit të aktiviteteve ndërgjegjësuese në zonat rurale dhe ndërrurbane në Shkodër, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit dhe informacionit të qytetarëve mbi aktivitetin e Qendrës së Ndhmës Juridike Falas pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe shërbimet që ato ofrojnë.
- Avokati/Avokatja ka për detyrë të bashkëpunojë me stafin e Qendrës së Ndhmës Ligjore Falas (QNFL) pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër për vlerësimin e nevojave të stafit dhe t’i përgjigjet këtyre nevojave gjatë orarit 08.00-16.00.
- Avokati/Avokatja duhet të organizojë për stafin e QNLF trajnime *on job* mbi baza ditore ose të tjera sipas nevojave të stafit të QNLF. Trajnimet mund të organizohen ballë për ballë ose on line.
- Avokati/Avokatja duhet të rrisë kapacitetet e stafit të QNFL në lidhje me mbështetjen e rasteve nga grupet e marginalizuara, si dhe të jetë i gatshëm për mentorimin e tyre sipas

nevojave që ata do shfaqin. Mentorimi mund të realizohet me takime ballë për ballë, ose përmes telefonit apo formave të tjera të komunikimit on line apo komunikimit elektronik.

- Avokati/Avokatja ka për detyrë të marrë pjesë dhe prezantojë eksperiencën e tij në aktivitetet e planifikuara të organizohen në bazë të projektit: si takimet e rrjetëzimit, trajnimet për organizatat e shoqërisë civile, etj.
- Avokati/Avokatja duhet të bashkëpunojë me qendrat që ofrojnë ndihmë ligjore ose shërbime të tjera sociale në Shkodër.
- Avokati/Avokatja duhet të respektojë kodin e sjelljes në marrëdhënien me përfituesit e ndihmës ligjore falas.
- Avokati/Avokatja ka detyrimin për të ndarë rastet e suksesshme me ekspertin/in e komunikimit dhe/ose me Koordinatorin Teknike të Projektit.
- Avokati/Avokatja ka për detyrë të raportojë te Koordinatorja Teknike e Projektit për punën e kryer në përfundim të çdo muaji.
- Të bashkëpunojnë me avokatët/juristët e Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare dhe stafin e projektit.

➤ **Periudha kohore:**

Detyrat dhe përgjegjësitë do të përmbushen deri në përfundim të zbatimit të projektit, Nëntor 2022.

➤ **Kualifikimet e kërkuara të kandidatëve:**

- Të këtë mbaruar studimet *bachelor* në drejtësi. Studimet *Master Shkencor/Profesional* ose ekuivalente me to janë të preferueshme.
- Të këtë të paktën 1 vit përvojë në informim, ndërgjegjësim e këshillim të qytetarëve, si dhe në ofrimin e ndihmës ligjore për grupet e marginalizuara dhe qytetarët në nevojë.
- Preferohet të këtë përvoja në çështjet gjyqësore në mbështetje të grupeve të marginalizuara.
- Të këtë licencë avokati.
- Të jetë njohës shumë i mirë i paketës microsoft office.
- Të jetë i/e motivuar në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi të caktuara.
- Përvoja e mëparshme pranë organizatave të shoqërisë civile, në mbështetje të grupeve të marginalizuara është shumë e vlerësueshme.

➤ **Pagesa:**

Pagesa e parashikuar është 50.000 ALL (pesëdhjetë mijë lekë) bruto në muaj.

➤ **Dokumentet:**

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentacionin si vijon:

1. Jetëshkrim/CV e kandidatit/es;
2. Kopje të diplomës, e shoqëruar me kopje të listës së notave të studimeve Bachelor dhe/ose Master, ose ekuivalente me to;
3. Licencën e avokatit;
4. Çdo dokumentacion i nevojshëm që tregon kualifikimet e kandidatit/es dhe përvojat e mëparshme;
5. Dëshmi penaliteti;
6. Preferohet të dorëzohet edhe një letër reference nga punëdhënës të mëparshëm, pedagogë ose partnerë të tjerë.

Dokumentacioni mund të dërgohet i skanuar në adresën e e-mail-it: avokatore2@yahoo.com, ose të depozitohet dorazi/postë pranë zyrave të Qendrës për Nisma Ligjore me adresë Rruga “Vaso Pasha”, Pll.12, Shk.1, Ap. 1, Tiranë.

➤ **Afati i aplikimeve:**

Afati i fundit i aplikimeve do të jetë data 24.06.2022, ora 16.00.

Qendra për Nisma Ligjore Qytetare rezervon të drejtën që ta shtyjë afatin e thirrjes ose ta anulojë atë, nëse aplikantët/et nuk përmbushin cilësinë dhe kriteret e kërkuara.